LIBËR PËR MËSIMDHËNËSIN

LËNDA: TIK

Klasa 10

AUTORËT

Zana Kurtishi Rudi, Arbnor Pajaziti, Vjollca Komoni, Enver Hamiti

PËRMBAJTJA

Hyrje..... 3
Planifikimi i kurrikulës për klasën X - Fusha JETA DHE PUNA..... 5
Qëllimi..... 6
Situata e të nxënit 6
STRUKTURA E LIBRIT TË NXËNËSIT DHE FLETORES SË PUNËS..... 6
PLANI MËSIMOR..... 7
PLANI VJETOR KLASA X.....8
PLANIFIKIMI 2-MUJOR (SHTATOR – TETOR).....10
PLANIFIKIMI 2-MUJOR (NËNTOR – DHJETOR).....12
PLANIFIKIMI 3- MUJOR (JANAR – SHKURT – MARS).....15
PLANIFIKIMI 3- MUJOR (PRILL – MAJ – QERSHOR).....19
Planifikimi ditor (modele planesh).....23
Vlerësimi i njohurive të nxënësve instrumentet e vlerësimit në TEMA.....172
Vlerësimi përmbledhës sipas periudhave.....181

Hyrje

Në ditët e sotme, TIK-u është bërë pjesë e jetës së nxënësve ndaj të cilës ata më së shumti kanë interes.

Fusha `Jeta dhe puna` në vete përmban katër koncepte bazë:

1. Teknologji e informimit dhe e komunikimit-TIK;

2. **Këshillim dhe orientim në karrierë;**

3. Puna dhe edukimi për ndërmarrësi;

4. Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

Si dhe dy module ndërlidhëse:

1. **Karriera ime** dhe 2. **Tregu i punës-Përgatitja për hulumtimin e tregut të punës**.

Temat kryesore të lëndës TIK janë:

1. Hyrje në programin Excel - formulat dhe funksionet;
2. Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku;
3. Krijimi i prezantimeve;
4. Multimedia, krijimi i sekuencave multimediale;
5. Karriera ime;
6. Ndërmarrësi i ri, tregu i punës dhe përgatitja për hulumtimin e tregut të punës;
7. Përdorimi i teknologjisë me shpenzim të ulët të energjisë elektrike;
8. Ndikimi i WiFi në shëndetin e njerëzve;
9. Sulmet kibernetike.

Këto tema krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të arritjes së kompetencave dhe rezultateve të fushës dhe lëndës mësimore.

Në këtë libër paraqitet edhe koha mësimore e planifikuar për secilën temë mësimore si udhërrëfyes për klasën e dhjetë.

Duhet të kemi parasysh se temat e trajtuara nga ndarja e kohës së orës mësimore ndryshojnë nga aplikimi prej klasës në klasë.

Kjo fushë është pjesë integruese pothuajse në të gjitha fushat e Kurrikulës së Kosovës dhe lëndët përbërëse. Në këtë fushë, nxënësit zhvillojnë aftësitë teknologjike dhe digjitale për të krijuar dhe komunikuar informacione të ndryshme dhe ide, zhvillojnë shkathtësi për të zgjidhur probleme, sfida dhe për të bashkëpunuar në shkollë dhe në shtëpi, për të qenë nxënës novativë të së ardhmes.

Përmes kësaj fushe të Kurrikulës, nxënësit do të marrin informata rreth roleve të ndryshme të individëve në jetë dhe punë, do të njihen me rolin e qytetarëve, anëtarëve të familjes, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Në këtë fushë nxënësit do të zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin për mundësitë e orientimit profesional në karrierë (përzgjedhja e profesionit), përdorimit të TIK-ut etj.

Të nxënit në fushën e Kurrikulës "Jeta dhe puna", nxënësve u mundëson:
njohuritë, të kuptuarit, shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja përmes:

- Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet;
- Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë;
- Këshillim dhe orientim në karrierë;
- Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme;
- Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë;
- Promovimi i kushteve të sigurta për jetë;
- Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme;
- Komunikimi në/për jetë dhe punë;
- Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit.

Fusha "Jeta dhe puna", konkretisht lënda e TIK, mund të ketë një korrelacion ndërlëndor me fushat e tjera për të integruar informatën dhe arritjen e rezultateve të përbashkëta të fushave. Ndërsa, te konceptet si këshillimi dhe orientimi në karrierë dhe ndërmarrësia do të zhvillohet moduli i cili bazohet në literaturën e librit të nxënësit në pjesën e veçantë.

Korniza e programit e librit të mësimdhënësit rrjedh nga: Korniza Kurrikulare e Kosovës, Kurrikula Bërthamë si dhe Programi Lëndor të cilat në vete ngërthejnë: Kompetencat e Kurrikulës së Kosovës, Konceptet, Rezultatet e fushës "Jeta dhe puna", qëllimin e fushës si dhe temat kryesore të kësaj fushe.

Përmes librit të mësimdhënësit, mësimdhënësit do të kenë mundësinë të njohin thellë programin e lëndës TIK, planin vjetor, planet dymujore, zbatimin e njësive mësimore metodologji dhe teknika adekuate të mësimdhënies në fokus nxënësin, ku qëllimi kryesor është të nxisim nxënësit të jenë aktiv dhe të bëhen përgjegjës për të mësuarit e tyre.

Zbatimi i këtij programi duhet të bëhet në raport me respektimin e parimit të barazisë gjinore, racës, fesë, etnisë dhe kulturës.

Planifikimi i kurrikulës për klasën X - Fusha JETA DHE PUNA

Kompetencat e të nxënit

FUSHA "JETA DHE PUNA"

LËNDA : TIK

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të menduarit
3. Kompetenca e të mësuarit
4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
5. Kompetenca personale
6. Kompetenca qytetare

REZULTATET E FUSHËS JETA DHE PUNA

1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet

2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë

3. Këshillimi dhe orientimi në karrierë

4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme

5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit

6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë

7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme

8. Komunikimi në/për jetë dhe punë

9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit

I0. Qëndrimet, vlerat dhe besimet

II. Aftësitë dhe shkathtësitë

12.Konceptet specifike

Konceptet e fushës

Teknologji e Informimit dhe Komunikimit -TIK

Punë dhe edukim për ndërmarrësi

Këshillim dhe orientim në karrierë

Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Qëllimet e arsimit parauniversitar

- Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;
- Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm;

Parimet e arsimit parauniversitar

- Gjithpërfshirja;
- Zhvillim i kompetencave;
- Mësimdhënie dhe mësimnxënie e integruar dhe koherente;
- Autonomia dhe fleksibiliteti;
- Përgjegjësia dhe llogaridhënia.

Qëllimi i programit të lëndës TIK

Lënda TIK synon të zhvillojë shkathtësitë praktike, profesionale dhe teknologjinë informative te nxënësit duke filluar me përdorimin e programit për llogaritje, programit për prezantim dhe orientimit dhe zhvillimit të shpirtit ndërmarrës, si dhe duke nxitur të nxënit në bashkëpunim, punën në grupe dhe krijimin e projekteve të ndryshme të TIK-ut.

Situata e të nxënit

Libri i mësimdhënësit është një material shumë i rëndësishëm për orën e mësimit.
Çdo njësi mësimore sipas temave përkatëse të lëndës do të trajtohet duke u mbështetur në arritjen e kompetencave të të nxënit, rezultateve të fushës dhe rezultateve të lëndës që nxënësit duhet të arrijnë përmes orëve mësimore.

Secila njësi mësimore përmban në vete veprimtari konkrete praktike ku paraqitet dhe realizimi i njësisë, metodologjia dhe trajtimi i njësisë përkatëse si dhe vlerësimi.

Njësitë mësimore shoqërohen me ilustrime dhe shpjegime konkrete të detajuara, ku do të ketë dhe pjesë për vlerësim dhe përsëritje ose ndërlidhje të klasës paraprake.
Ilustrimet janë të paraqitura me gjendje praktike reale ku paraqiten dhe kërkesa që nxënësit duhen t`i realizojnë gjatë orës mësimore.

Në çdo fillim të temës së re mësimdhënësi duhet t`ua prezantojë nxënësve terminologjinë, e cila është shumë e rëndësishme për aktivitetin mësimor, ashtu edhe familjarizimin e vetë nxënësve me këtë terminologji.

Informatat dhe ushtrimet gjatë orës mësimore plotësojnë njohuritë e dhëna nga mësimdhënësi.

Struktura e librit të nxënësit dhe e fletores së punës

Si libri i nxënësit, ashtu edhe fletorja e punës, përmbajnë saktësisht nga 9 tema që ndërlidhen me njëra-tjetrën.

Në përgjithësi çdo mësimi të librit të nxënësit i përgjigjet një detyrë me ushtrime të ndryshme praktike te fletorja e punës.

Libri i nxënësit dhe fletorja e punez kanë të njëjtit tituj të mësimeve dhe aktivitete që ndërlidhen dhe lehtësisht mund të dallohet kombinimi në mes tyre. Një njësi mësimore është parashikuar të zgjasë 45 minuta. Gjithsej libri mbulon 74 orë mësimore.

Programi lëndor – PLANI MËSIMOR – 74 orë mësimore

Teori - 39
Punë praktike/vlerësim njohurishë - 35

TEMA 1	•Hyrje në programin Excel - formulat dhe funksionet 14 orë •8 teori + 6 punë praktike
TEMA 2	•Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku 13 orë •5 orë teori + 8 punë praktike/vlerësim
TEMA 3	•Krijimi i prezantimeve 24 orë •11 orë teori + 13 praktikë/vlerësim
TEMA 4	•Multimedia, krijimi i sekuencave multimediale 8 orë •4 orë teori + 4 praktikë/vlerësim
TEMA 5	•Karriera ime 5 orë •4 orë teori + 1 orë punë praktike
TEMA 6	•Tregu i punës-Përgatitja për hulumtimin e tregut të punës 5 orë •3 orë teori + 2 praktikë/vlerësim
TEMA 7	•Përdorimi i teknologjisë me shpenzim të ulët të energjisë elektrike 2 orë •1 orë teori + 1 punë praktike
TEMA 8	•Ndikimi i WiFi në shëndetin e njerëzve 1 orë •1 orë teori
TEMA 9	· Sulmet kibernetike 9 orë · 2 orë teori dhe praktikë

Sqarim: *Plani mësimor duhet të adaptohet sipas ndryshimeve në planfikim të kalendarit për një vit shkollor. Ky është vetëm një model të cilin duhet ta merrni parasysh kur planifikoni. Ndryshimet mund të jenë pak orë mësimore.*

PLANI VJETOR

Fusha e kurrikulës: ___Jeta dhe puna_____ Klasa : _____X_____
Mësimdhënësi/ja: Viti shkollor _____

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

RNF:1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.
Analizojnë ndyshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe, përkatësisht gjejnë dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.
Shfrytëzojnë njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë në mënyrë individuale dhe në grup.
RNF:2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë
2.1. Demonstrojnë shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme të të nxënit.
RNF: 3. Këshillim dhe orientim në karrierë
3.1. Vlerësojnë shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme.
3.2. Ndërlidhin njohuritë dhe shkathtësitë personale me nevojat e tregut të punës.
RNF:4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.
4.1. Analizojnë disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe punë hulumtuese.
RNF:5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë
5.1. Prezantojnë ide kreative për krijimin e një biznesi duke u bazuar në analizën e tregut të punës.
RNF:7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme.
7.1. Lexojnë, interpretojnë dhe plotësojnë dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacionin dhe kërkesat e tregut të punës.
RNF:8. Komunikimi për jetë dhe punë
8.1. Përdorin multimedien për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.
RNF:9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit
9.1. Tregon kujdes për mjedisin e punës dhe arsyeton rolin e teknologjisë në ruajtjen e ambientit.

Lëndet e fushës kurrikulare L	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)	
	shtator-tetor	nëntor-dhjetor	janar-shkurt-mars	prill-maj qershor	
Lënda:TIK	1.Hyrje ne programin Excel-formulat dhe funksionet (14 orë) 2.Analizimi i të dhënave, Rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku (2 orë)	2.Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku (12 orë) 3.Krijimi i prezantimeve (4 orë) **Vlerësimi përmbledhës 1**	3.Krijimi i prezantimeve (20 orë) **Vlerësimi përmbledhës 2**	4.Multimedia, krijimi i sekuencave multimediale (8 orë) 5.Karriera ime (5 orë) 6.Ndërmarrësi i ri, tregu i punës dhe përgatitja për hulumtimin e tregut të punës (3 orë) 7.Përdorimi i teknologjisë me shpenzim të ulët të energjisë elektrike (2 orë) 8.Ndikimi i WiFi në shëndetin e njerëzve (1 orë) 9.Sulmet kibernetike (2 orë) **Vlerësimi përmbledhës 3**	**Tema 1:** I.1,2,3, II.2,4,5 III.1,3,6 IV.7 **Tema 2 :** I.1,9, II.4 III.1,3,4,5,7,8, IV.1 **Tema 3:** I.3,9, II.1, 2,3,4,5,6,7, III.1,5,6,9. IV.5,7 **Tema 4:** I.3, II.2,4,5,7, III.1,3,5,6,7,8 IV.2,3,5,7 **Tema 5:** I.1,3, 8,9, II.7,8, III.2,3,6,8, IV.4,9 **Tema 6:** I.1, 3, 9, II.4, III.1,2,3,5,7,8,9 **Tema 7:** I.3,9 II.4,6,7 IV.2,3,4,5,7 **Tema 8:** I.3,9 II.4,6,7 IV.2,3,4,5,7 **Tema 9:** II.1,2,5,6, III.3,4,5,6 IV.3,4

PLANI DYMUJOR _____Shtator-Tetor_____

Fusha e kurrikulës: __Jeta dhe puna___ Lënda mësimore: _____TIK_____ Klasa: _____X_____
Mësimdhënësi: _____ Viti shkollor _____

Tema mësimore:Tema 1: Hyrje në programin Excel-formulat dhe funksionet, **Tema 2:** Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:
Tema1: I.1,2,3, II.2,4,5 III.1,3,6 IV.7, **Tema2 :** I.1,9, II.4, III.1,3,4,5,7,8, IV.1

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

RNF: 1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet

1.1. Analizon ndryshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.
1.2. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë, në mënyrë individuale dhe në grup.

RNF:2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë

2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit.

RNF:4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme

4.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe punë hulumtuese.

RNF:8. Komunikimi për jetë dhe punë

8.1. Përdor multimedien për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe me situatat jetësore	Burimet
Hyrje në programin Excel - formulat dhe funksionet (14 orë) 2. Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku (2 orë)	▪ Shpjegon veprimet në lidhje me formulat. ▪ Lokalizon vendosjen e formulave në celulë. ▪ Cek shprehjet aritmetokore. ▪ Demonstron përmes shembujve përdorimi e disa funksioneve elementare insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritjen e shumës, prodhimit etj. ▪ Përdor funksione per punën me tekst, funksionet financiare dhe shpjegon rëndësinë e tyre. ▪ Identifikon zgjedhjen e problemeve gjatë përdorimit të funksioneve. ▪ Shpjegon sortimin rritës dhe zvogëlues si dhe bën filtrimin e të dhënave. ▪ Tregon për procedurën e krijimit të tabelave.	1.1 Hyrje në Excel 1.2 Menytë kryesore-shiritat 1.3 Krijimi i librave të punës dhe formatizimi 1.4 Organizimi i fletëve të punës 1.5 Punë praktike-tabelat 1.6. Formulat dhe funksionet 1.7. Veprimet me formula dhe operatorët 1.8. Funksionet-insertimi i funksioneve në formula 1.9. Përdorimi i referencës se celulave, adresimi absolut dhe relativ, i përzier 1.10. Funksionet logjike 1.11. Llogaritje të ndryshme-punë praktike 1.12. Përdorimi i formulave për manipulim me tekst 1.13. Numërimi, shkëputja, kërkimi dhe gjetja e karaktereve në një string 1.14. Gabimet në formula/funksione 2.1 Analizimi i të dhënave- sortimi 2.2 Filtrimi i të dhënave	14 2	Disa prej metodave të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin, si: - Mësimdhënia e integruar, - Mësimdhënia e diferencuar, - Shkathësitë përmes demonstrimit, - Puna përmes projekteve etj. - Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve), - Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur.	**Buletini i pjesëmarrjes** instrument për vrojtim **Lista e kontrollit** Identifikimi i elementeve të kryera (detyrat) **Portfolio e nxënësit** Mbledhje sistematike e të dhënave për vlerësim duke u bazuar në kërkesat dhe detyrat e caktuara. **Portfolio elektronike** - është një formë e cila tashmë mundëson integrimin e teknologjisë në detyrat dhe aktivitetet e nxënësve. Format e përmendura më lart janë më shumë vlerësim formativ i vazhdueshëm. Ndërsa për vlerësimin sumativ mund të përmendim testin përmbledhës.	Çështjet ndërkurrikulare që përfshihen në lëndën e TIK-ut janë: - Edukimi për qytetari demokratike - Edukimi për paqe - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për medie, - Puna vullnetare - Shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit përgjatë kurrikulës.	Libri i TIK klasa 10 Fletore pune klasa 10 Burime nga interneti Programet kompjuterike Enciklopedi Manuale të programeve nga interneti.

PLANI DYMUJOR _____Nëntor-Dhjetor_____

Fusha e kurrikulës: __Jeta dhe Puna___ Lënda mësimore: _____TIK_____ Klasa: _____X_____
Mësimdhënësi: _____ Viti shkollor _____

Tema mësimore: 2. Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku, 3. Krijimi i prezantimeve

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:
Tema 2: I.1,9, II.4, III.1,3,4,5,7,8, IV.1, **Tema 3:** I.3,9, II.1, 2,3,4,5,6,7, III.1,5,6,9. IV.5,7.

RNF:1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet

1.3. Analizon ndyshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.
1.4. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë në mënyrë individuale dhe në grup.

RNF:2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë

2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme të të nxënit.

RNF:4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme

4.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe punë hulumtuese.

RNF:8. Komunikimi për jetë dhe punë

8.1. Përdor multimedia për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
2. Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve dhe shtypja, grafiku (12 orë)	▪ Tregon hapat për printimin e të dhënave. ▪ Emërton fillimin dhe fundin e faqes. ▪ Demonstron organizimin e fletës punuese ▪ Ndërlidh hapat që duhet të perdoren për aktivizimin e sistemit grafik, (insertimi i një grafiku për tabelën e dhënë) ▪ Shpjegon llojet e grafikëve duke demonstruar	2.3. Rregullimi i faqeve 2.3.1 Formatizimi i të dhënave: tipi, madhësia fonti, etj. 2.3.2 Punë praktike- Dokumenti zyrtar 2.4 Shtypja e dokumentit 2.4.1 Kreu dhe fundi i faqes (Header-i dhe Footer-i) 2.4.2 Formatizimi i rreshtave dhe shtyllave 2.5 Krijimi i grafikut 2.5.1 Llojet e grafikut dhe dizajnimi 2.5.2 Formatimi i elementeve të grafikëve 2.5.3 Punë praktike- Grafiku statistikor 2.5.4 Përdorimi i diagrameve dhe shtypja e tyre 2.6 Vlerësim i	16	Disa prej metodave të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin, si: - Mësidhënia e integruar, - Mësimdhënia e diferencuar, - Shkathëitë përmes demonstrimit - Punë përmes projekteve etj. - Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e	**Buletini i pjesëmarrjes** instrument për vrojtim **Lista e kontrollit** Identifikimi i elementeve të kryera (detyrat) **Portfolio e nxënësit** Mbledhje sistematike e të dhënave për vlerësim duke u bazuar në kërkesat dhe detyrat e caktuara. **Portfolio elektronike** është një formë e cila tashmë mundëson integrimin e teknologjisë në detyrat dhe aktivitetet e nxënësve. Format e përmendura më lart janë më shumë	Çështjet ndërkurrikulare që përfshihen në lëndën e TIK-ut janë: - Edukimi për qytetari demokratike - Edukimi për paqe - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për medie - Puna vullnetare - Shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit përgjatë kurrikulës.	Libri i TIK klasa 10 Fletore pune klasa 10 Burime nga interneti Programet kompjuterike Enciklopedi Manuale të programeve nga interneti.

Krijimi i prezantimeve (4 orë)	hapat e insertimit të tyre. - Krahasojnë përparësitë e aplikacionit PowerPoint për prezantim me aplikacionet e tjera. - Tregon krijimin e një prezantimi të një teme të caktuar duke pasur parasysh edhe përdorimin e teknologjisë për të realizuar prezantimin. - Demonstrojnë përdorimin e efekteve në sllajde.	njohurive të nxënësve. 3.1 Startimi dhe puna me aplikacionin Power Point 3.2 Shiritat e funksioneve, mënyja e kontekstit, hapja, ruajtja e prezantimeve 3.3 Rregullimi i pamjes së sllajdeve 3.4 Punë praktike- Krijimi i prezantimit të parë 3.5 Vlerësimi përmbledhës.		pyetjeve drejtuar nxënësve) - Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur.	vlerësim formativ i vazhdueshëm. Ndërsa për vlerësimin sumativ mund të përmendim testin përmbledhës.		

PLANI ____Janar-Shkurt-Mars_____

Fusha e kurrikulës: __Jeta dhe Puna___ Lënda mësimore: _____TIK_____ Klasa: _____X_____
Mësimdhënësi: _____ Viti shkollor _____

Tema mësimore: 3.Krijimi i prezantimeve

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:
Tema 3: I.3,9, II.1, 2,3,4,5,6,7, III.1,5,6,9. IV.5,7.

RNF:1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet

1.5. Analizon ndyshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.
1.6. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë, në mënyrë individuale dhe në grup.

RNF:2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë

2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit.

RNF:4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme

4.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe punë hulumtuese.

RNF:8. Komunikimi për jetë dhe punë.

8.1. Përdor multimedia për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe me situatat jetësore	Burimet
3. Krijimi i prezantimeve (20 orë)	Krahasojnë përparësitë e aplikacionit PowerPoint për prezantim me aplikacionet e tjera. Tregon krijimin e një prezantimi të një teme të caktuar duke pasur parasysh edhe përdorimin e teknologjisë për të realizuar prezantimin. Tregon mënyrën e editimit të të dhënave në sllajde duke	3.6 Krijimi i një prezantimi të ri bazuar në template-s. Elementet e tekstit në sllajde. 3.6.1 Prezantimet ekzituese-formatizimi 3.6.2 Punë praktike-Prezantimi juaj 3.7.1 Insertimi, formatizimi dhe pamja e sllajdeve 3.7.2 Organizimi dhe dyfishimi i sllajdeve 3.7.3 Veprimet e ndryshme me komanda në sllajde 3.7.4 Startimi i një prezantimi, shtimi i tekstit dhe elementet e tjera 3.7.5 Formatizimi i sllajdeve: personalizimi, pamja, prapavija 3.8.1 Efeket në pamjen e sllajdeve dhe prezantimi në View	20	Disa prej metodave të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin, si: - Mësidhënia e integruar, - Mësimdhënia e diferencuar, - Shkathësitë përmes demonstrimit - Punë përmes projekteve etj. - Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur.	**Buletini i pjesëmarrjes** instrument për vrojtim **Lista e kontrollit** Identifikimi i elementeve të kryera (detyrat) **Portfolio e nxënësit** Mbledhje sistematike e të dhënave për vlerësim duke u bazuar në kërkesat dhe detyrat e caktuara. **Portfolio elektronike**-është një formë e cila tashmë mundëson integrimin e teknologjisë në detyrat dhe aktivitetet të nxënësve. Format e përmendura më lart janë më shumë vlerësim formativ i vazhdueshëm. **Ndërsa për vlerësimin sumativ** mund të përmendim **testin përmbledhës**.	Çështjet ndërkurrikulare që përfshihen në lëndën e TIK-ut janë: - Edukimi për qytetari demokratike - Edukimi për paqe - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për medie - Puna vullnetare - Shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit përgjatë kurrikulës.	Libri i TIK klasa 10 Fletore pune klasa 10 Burime nga interneti Programet kompjuterike Enciklopedi Manuale të programeve nga interneti.

	pasur parasysh sitlin e përdorur, madhësinë e tij dhe vendosjen e tekstit në pozitën e caktuar. Interpreton dizajnimet e ndërtuara duke dhënë sqarime për secilin sllajd të dizajnuar për prezantim. Shpjegon rëndësinë e paraqitjes së tekstit në sllajde. Tregon se gjatë krijimit të prezantimit në PowerPoint përveç teksteve mund të shfrytëzojë edhe materiale të tjera multimediale	3.8.2 Notes dhe Slide master 3.8.3 Animacionet gjatë ndërrimit të sllajdeve dhe zbatimi i tranzicionit të tyre 3.8.4 Punë praktike – Prezantimi im 3.8.5 Vlerësimi i njohurive të nxënësve 3.9.1 Puna me objekte të ndryshme në sllajde dhe rishikimi i prezantimit, insertimi i shenjave identifkuese dhe pikturave në sllajde 3.9.2 Projekti im për prezantim - Punë praktike 3.9.3 Formatizimi i elementeve në sllajde 3.9.4 Veprimet me komanda në sllajde 3.9.5 Veprimet me animacionet e tekstit dhe objekteve dhe shtypja e tyre 3.9.6 Animacionet e avansuara **VLERËSIMI PËRMBLEDHËS 2**					

	fotografi, incizime multimediale, vizatime, animacione etj. Demonstrojnë përdorimin e efekteve në sllajde. Diskuton rëndësinë e prezantimit. Përshkruan hapat gjatë fazës së printimit.						

PLANI DYMUJOR ____Prill-Maj-Qershor_____

Fusha e kurrikulës: __Jeta dhe Puna___ Lënda mësimore: _____TIK_____ Klasa: _____X_____
Mësimdhënësi: _____ Viti shkollor _____

Tema mësimore: 4.Multimedia, Krijimi i sekuencave multimediale, 5.Karriera ime, 6.Ndërmarrësi i ri, tregu i punës dhe përgatitja për hulumtimin e tregut të punës, 7.Përdorimi i teknologjisë me shpenzime të ulëta të energjisë elektrike, 8.Ndikimi i WiFi në shëndetin e njerëzve, 9.Sulmet kibernetike.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:
Tema4: I.3, II.2,4,5,7, III.1,3,5,6,7,8 IV.2,3,5,7, **Tema5:** I.1,3, 8,9, II.7,8, III.2,3,6,8, IV.4,9, **Tema6:** I.1, 3, 9, II.4, III.1,2,3,5,7,8,9

Tema7: I.3,9 II.4,6,7 IV.2,3,4,5,7, **TEMA8:** I.3,9 II.4,6,7 IV.2,3,4,5,7, **Tema9:** II.1,2,5,6, III.3,4,5,6 IV.3,4.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

RNF: 1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.
Analizon ndyshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe, përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.
Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë, në mënyrë individuale dhe në grup.
RNF:2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë
2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit.
RNF: 3. Këshillim dhe orientim në karrierë
3.1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e ardhshme.
3.2. Ndërlidh njohuritë dhe shkathtësitë personale me nevojat e tregut të punës.
RNF:4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.
4.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe punë hulumtuese.
RNF:5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë
5.1. Prezanton ide kreative për krijimin e një biznesi duke u bazuar në analizën e tregut të punës.
RNF:7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme.
7.1. Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacion dhe kërkesa të tregut të punës.
RNF:8. Komunikimi për jetë dhe punë
8.1. Përdor multimedie për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.
RNF:9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit
9.1. Tregon kujdes për mjedisin e punës dhe arsyeton rolin e teknologjisë në ruajtjen e ambientit.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe me situatat jetësore	Burimet
4.Multimedia 5.Këshillimi dhe orientimi në karrierë-Karriera ime	Tregojnë për avansimin dhe përparësitë e multimedies. Tregojnë për elementet themelore të grafikës, përpunimit të fotografive (figurave). Dallojnë kompjuterët të cilët shfrytëzohen gjatë dizajnimit ose prezantimit të sekuencave multimediale. Dallon cilësinë e një prezantimi të një materiali multimedial. Tregon krijimin e sekuencave multimediale duke përdorur programet përkatëse. Krijojnë sekuenca filmike dhe bëjnë prezantimin e tyre, duke marrë për bazë punët në dizajnim, përpunim grafik dhe projektim. Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës se çfarë janë të aftë të bëjnë.	4.1 Multimedia dhe rëndësia e saj 4.1.2 Fushat e aplikimit të multimedies, elementet themelore të grafikës-efektet 4.1.3 Punë praktike - Idea ime për multimedie 4.1.4 Punë praktike - vazhdim 4.2 Sekuencat filmike dhe prezantmi i tyre 4.2.1 Insertimi i sekuencave muzikore,video dhe formatizimi i tyre 4.2.2 Punë praktike 4.2.3 Vlerësim i njohurive 5.1 Planifikimi dhe vendim marrja për karrierën 5.2 Fazat e planifikimit të karrierës 5.3 Qëllimet për të zhvilluar karrierën 5.4 Hulumtimi i mundësive për karrierë përmes teknologjisë 5.5 Portofolio dhe CV-aplikimi për punë 6.1 Puna dhe edukimi për ndërmarrësi	8 5	Disa prej metodave të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin, si: - Mësidhënia e integruar, - Mësimdhënia e diferencuar, - Shkathësitë përmes demonstrimit - Punë përmes projekteve etj. - Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur.	**Buletini i pjesëmarrjes** instrument për vrojtim **Lista e kontrollit** Identifikimi i elementeve të kryera (detyrat) **Portfolio e nxënësit** Mbledhje sistematike e të dhënave për vlerësim duke u bazuar në kërkesat dhe detyrat e caktuara. **Portfolio elektronike**-është një formë e cila tashmë mundëson integrimin e teknologjisë në detyrat dhe aktivitetet e nxënësve. Format e përmendura më lart janë më shumë vlerësim formativ i vazhdueshëm. Informata kthyese Formë e reflektimit të përmirësimit në	Çështjet ndërkurrikulare që përfshihen në lëndën e TIK-ut janë: - Edukimi për qytetari demokratike - Edukimi për paqe - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për medie - Puna vullnetare - Shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit përgjatë kurrikulës.	Libri i TIK klasa 10 Fletore pune klasa 10 Burime nga internet i, Programet kompjuterike Enciklopedi Manuale të programeve nga internet i.

Puna dhe edukimi për ndërmarrësi-6.Tregu i punës-Përgatitja për hulumtimin e tregut të punës. 7.Përdorimi i teknologjisë me shpenzim të ulët të energjisë elektrike. **8.Ndikimi i WiFi në shëndetin e njerëzve.** **9.Sulmet kibernetike**	Shpjegojnë se si mund t'i arrijë qëllimet për të zhvilluar karrierën. Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë. Tregojnë për azhurnimin/përditësimin e portfolios personale. Përdorin aplikacione të ndyshme për ndërtimin e CV-së, përzgjedhin formën e duhur të CV-së dhe ndërtojnë përmbajtjen e saj. Vlerësojnë rëndësinë e hulumtimit të tregut të punës. Analizon praktikat dhe procedurat e tregut të punës. Vlerëson rëndësinë e hulumtimit të tregut të punës. Analizon praktikat dhe procedurat e tregut të punës. Dallon llojllojshmërinë e shkathtësive të tregut të punës. Hulumtojnë tregun e punës dhe tregojnë risitë rreth zhvillimit të tregut të punës. Analizon pajisjet teknologjike duke bërë krahasime rreth shpenzimeve energjetike dhe procesit të shpejtësisë	6.2 Tregu i punës-përgatitja për hulumtimin e tregut të punës 6.3 Punë praktike-profesioni im i së ardhmes 6.4 Zhvillimi i aftësive nëpërmjet edukimit të ndërmarrësisë 6.5 Punë praktike - Si të bëhemi ndërmarrës të suksesshëm 7.1 Përdorimi i teknologjisë me shpenzim të ulët të energjisë elektrike 7.2 Punë praktike-Të kursejmë energjinë me pajisje shtëpiake 8.1 Ndikimi i Ëi-Fi në shëndetin e njerëzve 9.1 Sulmet kibernetike 9.2 Rreziku nga interneti Parapërgatitje për vlerësim përmbledhës Vlerësimi përmbledhës 3	3 2 1 2		një detyrë ose projekt. Ndërsa për vlerësimin sumativ mund të përmendim - Testin përmbledhës		

	së tyre në përpunim. Tregojnë rëndësinë e pajisjeve të teknologjisë informative në shëndetin e njeriut. Përpunojnë informata rreth sulmeve kibernetike dhe shpjegojnë rëndësinë e tyre. Tregojnë për rreziqet nga interneti.						

PLANET DITORE:

TEMA 1 - Hyrje në programin Excel - Formulat dhe funksionet

Fusha kurrikulare: _Jeta dhe Puna / Lënda: TIK Shkalla e kurrikulës: 5 /Klasa: X

NJËSIA MËSIMORE 1 - Hyrje në Excel

Ky mësim paraqet informatat hyrëse për programin për llogaritje Excel.

RNSH: *I.1,2, II.2,4, III.1,3*

RNF: *1.1, 2.1,4.1,8.1*

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veprimet në lidhje me formulat.
- Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritjen e shumës, prodhimit etj.).

Kriteret e suksesit:

- Trego së paku 3 meny kryesore të Excel-it.
- Krahaso rreshtin nga shtylla.
- Shkruaj të dhëna në Excel.

Fjalët kyçe:_____

Burimet: Libri i nxënësit, programi Excel.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

PJESA HYRËSE

Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve faqen e Excel-it dhe u parashtron pyetje nxënësve:



Çfarë po shihni? Jepni mendimet tuaja.

PJESA KRYESORE

Më pas në projektor ose kompjuter paraqet disa informata kryesore të cilat nxënësit duhet t`i dinë për të punuar dhe llogaritur me Excel.

Kërkohet nga nxënësit që në internet të hulumtojnë rreth Excelit, rëndësinë dhe llojet.

Më pas të diskutohet në grup të madh rreth të gjeturave dhe mësimdhënësi/ja plotëson informatën e mbetur.

Përdoret për llogaritje matematikore, statistika, tabela etj.

PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit udhëzohen të hapin Excelin dhe të përdorin për pak minuta sipas dëshirës, më pas duhet të shkruajnë disa të dhëna me udhëzime të mësimdhënësit/es.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi/ja përmes informatës kthyese merr informata rreth njohurive që nxënësit kanë marrë në këtë orë mësimore dhe jep mbështetje rreth përmirësimit.

AKTIVITETE SHTESË

Udhëzohen nxënësit që në shtëpi, të instalojnë Excelin dhe të praktikojnë shkurt, të shkruajnë shkronja dhe numra në faqe.

Fusha kurrikulare: _Jeta dhe Puna / Lënda: TIK Shkalla e kurrikulës: 5 /Klasa: X

NJËSIA MËSIMORE 1.2 - Menytë kryesore - Shiritat

Ky mësim përshkruan përdorimin e menyve kryesore të Excelit si dhe rëndësinë e funksionin e shiritave.

RNSH: *I.1,2,3,II.4,5,III.1,3,IV.7*

RNF: *1.1, 2.1,4.1,8.1*

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan rëndësinë dhe funksionin e shiritave dhe menyve.
- Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritjen e shumës, prodhimit etj.).

Kriteret e suksesit:

- _____
- _____
- _____

Fjalët kyçe:_____

Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, programi Excel.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

PJESA HYRËSE



Nxënësve iu paraqitet një pamje ku janë të paraqitura menytë dhe kërkohen nga ata të japin nga një mendim për secilën duke i lexuar emrat e tyre.

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi/ja në projektor ose kompjuter paraqet funksionet kryesore të menyve dhe realizon disa veprime me to në dokument të Excelit.

Nga njësia 1.5 deri 1.6.1 në libër të nxënësit mund të marrin informata më shumë rreth shiritave dhe menyve.

PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit të ndarë në dyshe praktikojnë veprime të ndryshme me menytë kryesore dhe shiritat dhe më pas plotësojnë detyrën praktike 1.1 dhe 1.2 në fletore pune.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi/ja përmes realizimit të detyrave, veprimeve dhe bashkëpunimit vlerëson duke i vëzhguar në punë.

Situata e të nxënit quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të përmbushin arritjen e rezultateve të lëndës në bashkëpunim me RNSH dhe RNF.

AKTIVITETE SHTESË

Plotësoni:

_____

_____

Fusha kurrikulare: _Jeta dhe Puna / Lënda: TIK Shkalla e kurrikulës: 5 /Klasa: X

NJËSIA MËSIMORE 1.3 - Krijimi i librave të punës dhe formatizimi

Ky mësim paraqet praktikisht se si krijohen librat e punës dhe si mund t`i formatizojmë dhe ndryshojmë sipas nevojave tona.

RNSH: _____ *(shih planin shtator-tetor dhe plotëso)*

RNSH: _____ *(shih planin shtator-tetor dhe plotëso)*

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Cek shprehjet aritmetikore.
- Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritjen e shumës, prodhimit etj.).
- Përdor funksione për punën me tekst, funksionet financiare dhe shpjegon rëndësinë e tyre.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj si krijohet një libër i punës.
- Analizo elementet kryesore të librit të punës.
- Krijo një libër të punës sipas udhëzimeve të mësimdhënësit/es.

Fjalët kyçe:_____

Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, Excel.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

_____

PJESA HYRËSE

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që në libër të shohin me kujdes si hapet një libër i punës në Excel.

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi demonstron praktikisht krijimin e një libri në Excel dhe hap pas hapi shpjegon elementet dhe rëndësinë e secilit funksion dhe veprim.

1. Hapja e Excelit, 2. Emërtimi i dokumentit (krijimi i librit), ruajtja e tij në lokacionin përkatës dhe në fund plotësimi me të dhëna.

Udhëzimet e qarta janë të dhëna në libër të nxënësit njësia 1.7 deri 1.9.

PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit udhëzohen që në dyshe të plotësojnë detyrat 1.3 në fletore pune dhe praktikisht të provojnë kërkesat e detyrës 1.4 në fletore pune dhe udhëzimet e tjera nga mësimdhënësi.

Më pas prezantojnë detyrat e kryera dhe diskutojnë rreth rezultateve.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi/ja, përmes kërkesës së bërë dhe listës së kontrollit vlerëson arritjen e shpjegimit të ecurisë së krijimit të librit me komandat dhe veprimet e caktuara si dhe krijimin dhe ruajtjen e librit të punës sipas detyrave në fletore pune.

AKTIVITETE SHTESË

Detyrë shtëpie:

Udhëzohen nxënësit të krijojnë një libër në Excel në shtëpi dhe sipas dëshirës të prezantojnë disa të dhëna.

Fusha kurrikulare: _Jeta dhe Puna / Lënda: TIK Shkalla e kurrikulës: 5 /Klasa: X

NJËSIA MËSIMORE 1.4 - Organizimi i fletëve të punës

Ky mësim paraqet praktikisht insertimin, fshirjen dhe formatizimin e fletëve të punës në raport me librin e punës.

RNSH: _____ *(shih planin shtator-tetor dhe plotëso)*

RNF: _____ *(shih planin shtator-tetor dhe plotëso)*

Rezultatet e të nxënit të lëndës:	Kriteret e suksesit:
Nxënësi/ja: - *Përshkruan organizimin e fletëve të punës në libër.* - *Karahason librin e punës me fletët e punës.* - *Krijon fletë të punës në Excel.*	- _____ - _____ - _____

Fjalët kyçe:_____

Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, Excel.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

PJESA HYRËSE

Mësimdhënësi/ja u parashtron pyetje nxënësve:

Cilat janë elementet kryesore të Librit të punës?

Më pas kur nxënësit përgjigjen, mësimdhënësi/ja fokuson diskutimin fillestar rreth njohurive që nxënësit kanë rreth funksionit që kryejnë fletët e punës në Excel.

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi/ja demonstron praktikisht insertimin dhe formatizimin e fletëve të punës, fshirjen, dyfishimin:
SHEET- Fleta e punës 1. Renditet automatikisht pas hapjes së librit të punës në Excel.



Insertimi i fletës tjetër të punës bëhet me: 1. Tasti i djathë mbi fletë të punës dhe INSERT ose shenja .
Formatizimi dhe organizimi i fletëve të punës është e sqaruar dhe në libër të nxënësit njësia 1.11 deri 1.12, ku dhe sqarohet shtimi i një flete, kopjimi i një flete me të dhëna dhe formatizime të tjera. Gjithashtu mësimdhënësi demonstron dhe komandat Copy, Paste, për menaxhimin e të dhënave në fletë të punës.
Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të realizojnë detyrën 1.6 në fletore pune.

PJESA PËRFUNDIMTARE

Në fletore pune nxënësit udhëzohen t`iu përgjigjen pyetjeve nga detyra praktike 1.5 në fletore pune, pasi të kenë praktikuar të gjitha kërkesat e pyetjeve përmes Excelit.

VLERËSIMI

Përmes diskutimit dhe përgjigjeve në pyetje mësimdhënësi/ja vlerëson arritjen e rezultateve të lëndës dhe qëllimin e orës mësimore.

AKTIVITETE SHTESË

Detyrë shtëpie: Krijo një libër të punës në Excel me emrin Shkolla, në libër inserto 5 fletë të punës dhe secila nga ato duhet të përmbajë ngjyra të ndryshme të butonëve dhe brenda duhet të përmbajnë të dhënat e orarit javor për secilën ditë veç e veç.

Fusha kurrikulare: _Jeta dhe Puna / Lënda: TIK Shkalla e kurrikulës: 5 /Klasa:X

NJËSIA MËSIMORE 1.5 - Punë praktike -Tabelat

Ky mësim mundëson njohjen e krijimit të tabelave, të dhënave të ndryshme në fletë dhe libër përmes punës praktike.

RNSH: _____ *(shih planin shtator-tetor dhe plotëso)*

RNF: _____ *(shih planin shtator-tetor dhe plotëso)*

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon zgjidhjen e problemeve gjatë përdorimit të funksioneve.
- Tregojnë për procedurën e krijimit të tabelave.
- _____

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj si formohen tabelat në Excel.
- Analizo rolin e rreshitit dhe shtyllës në tabelë.
- Krijo tabelën me 5 shtylla dhe 7 rreshta me të dhëna.

Fjalët kyçe: _____

Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, Excel.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

PJESA HYRËSE



Mësimdhënësi/ja fillimisht u dorëzon listat me emra të nxënësve, notat e lëndëve përkatëse dhe në fund kërkon që për çdo lëndë të jetë një shtyllë dhe për çdo nxënës një rresht. Dhe më pas udhëzon për vazhdimin e praktikës në kompjuter.

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi/ja pas detyrës së parë demonstron praktikisht si të formohet një tabelë me të dhënat e paraqitura më lart dhe ngadalë përmes projektorit paraqet çdo hap praktik.

	Emri dhe mbiemri i nxënësit	Gjuhë shqipe	Matematike	Teknologji me TIK
1	Nxënësi 1			
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				

Çdo nxënës në dyshe praktikon shembullin e demonstruar nga mësidhënësi.

PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit udhëzohen të kryejnë detyrën praktike 1.7 fletore pune.

Më pas prezantojnë detyrën e tyre.

VLERËSIMI

Plotëso:_____

_____

AKTIVITETE SHTESË

Plotëso:_____

_____

Fusha kurrikulare: _Jeta dhe Puna / Lënda: TIK Shkalla e kurrikulës: 5 /Klasa: X

NJËSIA MËSIMORE 1.6 - Formulat dhe funksionet

Ky mësim përshkruan rolin dhe funksionin e formulave dhe funksioneve në Excel.

RNSH: *I.1,2,3,II.2,5,III.1,3,6*

RNF: *1.1,2, 2.1,4.1,8.1*

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veprimet në lidhje me formulat.
